



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT  
INSPEKTORATI SHTETËROR I PUNËS DHE SHËRBIMEVE SHOQËRORE  
DREJTORIA QENDRORE

Nr. 744/8 prot.

Tiranë, më 21.05, 2026

Lënda: Shpallje për subjektin:

**“ALBALKA GROUP” ME NIPT M21829038R**

*Rruga “Marije Kraja” Njesia Admin.nr.3, Ap.nr.6, kati 2.*

**Tiranë**

Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Drejtoria Qëndrore, ka kryer inspektim në subjektin “ALBALKA GROUP” me nipt M21829038R dhe adresë Rruga “Marije Kraja” Njesi Admin. nr.3, Ap.nr.6, kati 2. si dhe me adresë të dytë të padeklaruar: Zogu i Zi, Pallati Katar, kati 6., Ap.23. Gjatë procesit të inspektimit bazuar në ligjin nr.99, datë 12.09.2024 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", është mbajtur Vendimi Përfundimtar i inspektimit me Nr. ISHPSHSH-DQ-2026-000030-5, datë 12.05.2026.

Në zbatim të procedurave që parashikon ligji nr.99, datë 12.09.2024 "Për Inspekimin në Republikën e Shqipërisë", njoftimi i subjektit për vendimin përfundimtar të inspektimit nuk është bërë i mundur të kryhet nëpërmjet dorëzimit personal dhe me postë në adresën ku subjekti ushtron aktivitet, adresa e deklaruar në ekstraktin e QKB-së. Objekti postar është kthyer mbrapsht nga të dy adresat me shënimet: “Adresë e pamjaftueshme” (nuk pergjigjet në telefon).

Bazuar në nenin 162 të ligjit nr. 44/2015 Kodi Procedurës Administrative, Drejtoria Qendrore e ISHPSHSH-së ka vendosur, njoftimin e subjektit “ALBALKA GROUP” me nipt M21829038R dhe adresë Rruga “Marije Kraja” Njesia Admin.nr.3, Ap.nr.6, kati 2 për njohjen me vendimin përfundimtar të inspektimit me anë të shpalljes dhe njoftimit duke e afishuar në zyrat e ISHPSHSH-së, në adresën e subjektit ku është ushtruar inspektim, QKB dhe në mjediset e Drejtorisë Qëndrore të ISHPSHSH-së dhe në faqen zyrtare të web.

Në zbatim të pikës 3 të nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 Kodit të Procedurës Administrative njoftimi do të vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Kundër Vendimit Përfundimtar, subjekti ALBALKA GROUP ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë “Komisionit të Shqyrtimit të Ankimit”, në Inspektoratin e Përgjithshëm, sipas nenit 55, të ligjit nr. 99, datë 12.09.2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Për njohjen me përmbajtjen e plotë të Vendimit Perfundimtar të Inspektimit dhe marrjen e kopjes së tij mund të paraqiteni pranë Drejtorisë Qendrore të ISHPSHSH-së, me adresë Rr. "Sheh Ahmet Pazari", nr.10, Tiranë.

Ky njoftim shpallet sot më datë 21.05.2026 dhe qëndron i afishuar deri në datë 31.05.2026.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**KRYEINSPEKTORI**  
**Eljo Muçaj**

A handwritten signature in blue ink is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISE-LINDORE" at the top, "DREJTORIA QENDRORE E SHQIPËRISE SHQËRORE" in the middle, and "INSPEKTORATI QENDRORE I TREGETISE DHE EKONOMISE DITORE" at the bottom. The signature is a stylized, cursive script.